



TREGUESIT STATISTIKOR TË SHËRBIMEVE POSTARE

Tremujori III 2022

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Përmbajtje

I . HYRJE.....	3
II. PANORAMË E PËRGJITHSHME	3
III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE	5
1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare	5
2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare	8
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar	7
4. Treguesit e shërbimit ekspres.....	8

I. HYRJE

AKEP, me qëllim informimin e palëve të interesuara me treguesit kryesorë të tregut postar, sipas raportimeve të bëra nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar “Posta Shqiptare” sh.a. dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare ka përgatitur këtë raport në të cilin evidentohen treguesit kryesorë të tregut postar për tremujorin e tretë të vitit 2022, si edhe krahasimet me tremujorin e dytë të vitit 2022 dhe me tremujorin e tretë të vitit 2021, i cili publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al, në seksionin “Statistika rreth AKEP” - “Shërbimet Postare”.

Raporti ka natyrë periodike dhe përditësohet vazhdimisht me të dhënat statistikore të shërbimeve postare.

II. PANORAMË E PËRGJITHSHME

Në këtë raport statistikor janë paraqitur të dhënat periodike statistikore të shërbimeve postare për tremujorin e tretë të vitit 2022 të dërguara nga Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare të pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare”, në zbatim të kërkesave të Rregullores Nr.40, Datë 17.12.2015 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike mbi shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve postare”.

Subjektet e pajisur nga AKEP me “Autorizim të Përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare” të regjistruar në regjistrin e AKEP për periudhën e raportimit janë:

- **Ofruesi i Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare sh.a.**
- **Ofruesit e shërbimeve postare (37 subjekte):**
 1. DHL International (Albania) sh.p.k;
 2. T.N.T Express Albania sh.p.k;
 3. Albanian Cargo Service sh.p.k. (A.C.S.);
 4. United Transport sh.p.k. (Uni Trans);
 5. Ulysses Enterprises sh.p.k. (Fedex);
 6. Albanian Delivery Express sh.p.k;
 7. Youth Albania Professional Services (YAPS) (Fondacion);
 8. COEX sh.p.k;
 9. ALBANIAN PARCEL DISTRIBUTION sh.p.k;
 10. INTEX COURIER sh.p.k;
 11. TURBOO ALBANIA sh.p.k;
 12. Blendi Dokollari – Person Fizik (Flash Delivery Albania);
 13. Balkan Courier & Logistics sh.p.k;
 14. I V Y sh.p.k;
 15. ALOPOST sh.p.k;
 16. IDEX IdealExpress sh.p.k. (ish All In One Cool sh.p.k.);
 17. Mr. COURIER sh.p.k;

18. Top Post sh.p.k;
19. Fenix Post & Delivery Albania sh.p.k;
20. Greenposta sh.p.k;
21. NOEX Courier & Delivery sh.p.k;
22. Fast Express Post sh.p.k;
23. Alfa Courier Services shp.k;
24. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.);
25. BIPEX sh.p.k;
26. IPOST sh.p.k;
27. COURIER GROUP sh.p.k;
28. EXPRESS ALB 24 sh.p.k;
29. POSTA JONË sh.p.k;
30. DANDEX COURIER EXPRESS sh.p.k;
31. PRIME EXPRESS sh.p.k;
32. GENIKI TAXYDROMIKI ALB sh.p.k;
33. AVARI sh.p.k;
34. POSTMAN sh.p.k;
35. Ndriçim Osmani (Person fizik);
36. Ultra C.E.P. sh.p.k;
37. GED sh.p.k. (ish B.E.D. sh.p.k.).

Gjatë periudhës, nga tremujori i dytë i vitit 2022 deri në tremujorin e tretë të vitit 2022, nuk ka asnjë subjekt të çregjistruar për ofrimin e shërbimeve postare dhe kanë raportuar të dhënat statistikore 26 subjekte¹.

Posta Shqiptare me VKD Nr.13, datë 30.06.2020 është pajisur nga AKEP me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal postar.

¹ Ofrues të shërbimeve postare që kanë raportuar të dhënat statistikore në AKEP deri më datë 20.10.2022

III. PËRMBAJTJA E TË DHËNAVE

Të dhënat statistikore postare të dërguara nga ofruesit e shërbimeve postare përbajnë kryesisht:

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare;
2. Treguesit e shërbimit universal postar;
3. Treguesit e shërbimit jo universal postar;
4. Treguesit e shërbimit ekspres.

1. Treguesit e totalit të shërbimeve postare

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022 rezultojnë 7,277,715 objekte postare të pranuar dhe të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e Shërbimeve Postare, të dhëna në mënyrë më të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela 1.1: Të dhëna përmblendhëse të objekteve postare sipas shërbimeve postare të ofruara

Shërbime postare të ofruara	T3_2021	T4_2021	T1_2022	T2_2022	T3_2022	Ndryshim T3_2022/ T2_2022	Ndryshim T3_2022/ T3_2021
Posta Shqiptare sh.a							
1 Shërbim Universal Postar							
1 Postë brenda vendit	5,113,495	5,159,865	5,087,129	5,234,188	5,001,676	-4.4%	-2%
1 Postë ndërkombëtare	155,708	169,788	158,687	162,271	222,394	37.1%	43%
1 Totali 1.1+1.2	5,269,203	5,329,653	5,245,816	5,396,459	5,224,070	-3.2%	-1%
2 Shërbim jouniversal postar							
2 Postë brenda vendit	117,301	16,320	80,114	118,161	106,925	-9.5%	-9%
2 Postë ndërkombëtare	707	458	381	403	431	6.9%	-39%
2 Totali 2.1+2.2	118,008	16,778	80,495	118,564	107,356	-9.5%	-9%
3 Shërbim ekspres							
3 Ekspres brenda vendit	183,171	173,684	156,598	140,469	119,412	-15.0%	-35%
3 Ekspres ndërkombëtar	4,515	4,534	4,992	2,435	4,340	78.2%	-4%
3 Totali 3.1+3.2	187,686	178,218	161,590	142,904	123,752	-13.4%	-34%
Ofruesit e tjerë të shërbimeve postare							
4 Shërbim JoUniversal Postar							
4 Postë brenda vendit	365,123	333,541	331,957	558,871	554,520	-0.8%	52%
4 Postë ndërkombëtare	19,026	14,774	16,286	14,456	9,575	-33.8%	-50%
4 Totali 4.1+4.2	384,149	348,315	348,243	573,327	564,095	-1.6%	47%
5 Shërbim ekspres							
5 Ekspres brenda vendit	927,403	915,309	670,509	962,927	1,200,322	24.7%	29%
5 Ekspres ndërkombëtar	60,706	11,586	58,354	54,322	58,120	7.0%	-4%
5 Totali 5.1+5.2	988,109	926,895	728,863	1,017,249	1,258,442	23.7%	27%
6 Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	6,947,154	6,799,859	6,565,007	7,248,503	7,277,715	0.4%	5%

Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e tabelës 1.1, vërehet rënie e lehtë në totalin e shërbimeve postare për zërin "Shërbim universal postar", edhe nga krahasimi me të njëjtën periudhë një vit më parë evidentohet rënie me rreth 1%. Në lidhje me shërbimin jo-universal postar, të Postës Shqiptare, vërehet rënie në zërin 'Postë brenda vendit' krahasuar kjo si në raport me periudhën pararendëse, ashtu edhe me periudhën respektive të një viti më parë, ndërkohë në zërin "Postë ndërkombëtare" gjatë tremujorit të tretë 2022 krahasuar me tremujorin pararendës ka pasur rritje

me rreth 7%, ndërkohë nga krahasimi me të njëjtën periudhë të vitit 2021 ky zë është ulur me rreth 39%. Zëri “Ekspres brenda vendit” për Postën Shqiptare gjatë tremujorit të tretë 2022 rezulton në rënie si në krahasim me tremujorin pararendës ashtu edhe me periudhën respektive gjatë vitit 2021, ndërkohë zëri “Ekspres ndërkombëtar” për Postën Shqiptare rezulton me rritje të ndjeshme rreth 78% krahasuar tremujori i tretë 2022 me periudhën pararendëse dhe rënie në krahasim me tremujorin e dytë 2021 rreth 4%.

Në ndryshim nga ecuria e treguesve të Postës Shqiptare, zëri ‘Postë brenda vendit, në shërbimin jo-universal postar për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, rezultoi me rënie të lehtë për tremujorin e tretë 2022 krahasuar me periudhën pararendëse, ndërkohë, është shoqëruar me rritje të ndjeshme rreth 52% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021. Lidhur me shërbimin jouniversal postar, zëri “Postë ndërkombëtare” ka shënuar rënie të ndjeshme për ofruesit e tjerë postar, rënie e cila ka rezultuar rreth 34% gjatë tremujorit të tretë 2022 në krahasim me tremujorin e dytë 2022, dhe rreth 50% rënie nëse krahasohet me të njëjtën periudhë të vitit 2021.


Për sa i përket zërit “Ekspres kombëtar” për ofruesit e tjerë vërehet rritje e ndjeshme gjatë tremujorit të tretë 2022 krahasuar kjo si me tremujorin pararendës ashtu edhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë respektivisht rreth 25% dhe 29%. Zëri ‘ekspres ndërkombëtar’, për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare rezultoi me rritje në T3_2022 krahasuar me T2_2022 dhe me rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.

Tabela 1.2: Totali i objekteve postare-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3_2022

Totali i objekteve postare		
	Objekte postare	Pjesë tregu
<i>P. Sh</i>	5,455,178	75%
<i>Of. e tjerë</i>	1,822,537	25%
Totali	7,277,715	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.1: Totali i shërbimeve postare, krahasimi në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.1 më sipër, shikojmë një rënie në objektet postare në T3_2022 krahasuar me T2_2022, për Postën Shqiptare ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kemi një rritje, gjithashtu kemi një rënie të totalit të objekteve postare për Postën Shqiptare krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë ndërsa për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

Tabela 1.3: Totali i objekteve postare sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare T3_2022


Totali i objekteve postare sipas llojit të shërbimit

Sh. U	Sh. jo univers.	Sh. ekspres	Totali
5,224,070	671,451	1,382,194	7,277,715
71.8%	9.2%	19%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e raportuara rezulton se volumin më të madh të objekteve postare e zë shërbimi universal postar me 71.8%, ndjekur nga shërbimi ekspres me 19% dhe shërbimi jo universal 9.2%.

Grafiku 1.2: Ecuria në 3-mujor sipas llojeve të shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafikun 1.2, vërehet që pjesën më të madhe të shërbimeve postare e zë Shërbimi Universal Postar. Nga krahasimi i periudhës T3_2022 me periudhën T2_2022 vërehet që është pothuajse në të njëjtat nivele volumi total i shërbimeve postare, ndërsa rritje vërehet duke krahasuar me të njëjtën periudhë, një vit më parë, në masën rreth 5%.

2. Treguesit e Shërbimit Universal Postar – Posta Shqiptare


Tabela 1.4: Shërbimi Universal Postar T3_2022

Shërbimi Universal Postar	
Postë brenda vendit	5,001,676
Postë ndërkombëtare	222,394
Totali	5,224,070

Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga të dhënat e tabelës 1.4 për T3_2022, për sa i përket shërbimit Universal Postar, vihet re se Posta Shqiptare realizoi gjithsej 5,224,070 objekte, nga të cilat posta brenda vendit zë 96% të objekteve postare dhe posta ndërkombëtare zë 4% të objekteve postare. Për sa i përket Shërbimit Universal brenda vendit, janë regjistruar 4,238,671 shërbime për objekte të thjeshta dhe 763,005 shërbime për objekte të regjistruara/shërbime të veçanta. Në lidhje me Shërbimin Universal Postar Ndërkombëtar, janë regjistruar 56,215 objekte postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit dhe 166,179 objekte hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri.

Grafiku 1.3: Shërbimi universal postar - Ecuria në 3 muaj



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Nga grafiku i mësipërm, shikohet një rënie e shërbimit universal postar në T3_2022 krahasuar me T2_2022, me 3%.

3. Treguesit e totalit të shërbimeve postare - Posta Shqiptare

Në vijim paraqiten treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, të dërguara nga Posta Shqiptare:


Tabela 1.5: Treguesit e realizimit të Shërbimeve Postare në total sipas zërave përkatës, P. Sh

Llojet e shërbimeve	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2022	Pjesë tregu T3_2021
Shërbim universal postar	5,224,070	96%	95%
Shërbim jo universal postar	107,356	2%	2%
Shërbim ekspres	123,752	2%	3%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Nga të dhënat e Tabelës 1.5 vihet re se volumin kryesor në shërbimet postare, që ofron Posta Shqiptare e zë shërbimi universal me 96%, i ndjekur nga shërbimi ekspres me 2% dhe nga shërbimi jo universal postar 2%.

Grafiku 1.4: Llojet e shërbimeve postare të ofruara nga Posta Shqiptare – Ecuria në 3-mujor



Burimi: Posta Shqiptare. Përpunimi: AKEP

Grafiku 1.4 paraqet ecurinë e objekteve postare të Posta Shqiptare, ku vihet re një rënie për shërbimin universal, shërbimin jo universal dhe për shërbimin ekspres në T3_2022 krahasuar me T2_2022.

4. Treguesit e shërbimit jo universal postar – P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim jepen të dhënat statistikore të marra së bashku për Postën Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për shërbimin jo universal.

Tabela 1.6: Shërbimi jo universal postar (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare)

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2022	Pjesë tregu T3_2021
P.Sh	107,356	16%	24%
Of. e tjerë	564,095	84%	76%
Totali	671,451	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafiku 1.5: Shërbimi jo universal postar, Posta shqiptare/ofruesit e tjerë. Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Për sa i përket shërbimit jo universal, objektet postare të realizuara në T3_2022 krahasuar me T2_2022 kanë pësuar rënie për Postën Shqiptare dhe për ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Numri i objekteve të shërbimit jo-universal postar për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare gjatë T3_2022 përbëhet nga 661,445 objekte brenda vendit dhe 10,006 objekte për shërbimin jo-universal jashtë vendit.

5. Treguesit e shërbimit ekspres - P.SH dhe Ofruesit e tjerë


Në vijim paraqitet informacion mbi treguesit e shërbimit postar ekspres për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2022, si edhe të dhënat për periudhat krahasuese për vitin 2021, mbi baza tremujore.

Tabela 1.7: Shërbimi ekspres-Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë të Shërbimeve Postare për T3_2022

Ofruesit	Nr. Objekteve	Pjesë tregu T3_2022	Pjesë tregu T3_2021
P. Shqiptare	123,752	9%	16%
Of. e tjerë	1,258,442	91%	84%
Totali	1,382,194	100%	100%

Burimi: Të dhëna të llogaritura nga AKEP mbi bazën e pjesëve të tregut

Grafik 1.6: Shërbimi ekspres - Posta shqiptare/ofruesit e tjerë, Ecuria në 3-mujor



Burimi: Ofruesit e shërbimeve postare. Përpunimi: AKEP

Shërbimi ekspres, gjatë T3_2022 ka pësuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë një vit me parë ashtu edhe me tremujorin paraardhës T2_2022.

Shërbimi ekspres brenda vendit për Postën Shqiptare dhe ofruesit e tjerë së bashku është në vlerat 1,319,734 objekte postare ose 95%, dhe shërbimi postar ekspres ndërkombëtar në vlerën 62,460 objekte postare ose 5%.

Për sa i përket postës ndërkombëtare në shërbimin ekspres, sasia e objekteve hyrëse nga jashtë vendit dhe të shpërndara në Shqipëri është në vlerën 39,500 objekte dhe sasia e objekteve postare të pranuar në Shqipëri dhe të dërguara jashtë vendit është në vlerën 22,960 objekte.